

NERTILA ZANI

**PËRDORIMI I KONEKTORËVE LOGJIKË
NË TEKSTIN ARGUMENTUES**

**Studiuar në fjalimin e Fan Nolit, mbajtur në Lidhjen e Kombeve, në
Asamblenë e Pestë të Lidhjes, më datë 10 shtator 1924.**

Në këtë punim kemi parë përdorimin e konektorëve dhe rolin që ata luajnë në tekstin argumentues. Siç e dimë, konektorët janë elemente lidhëse ndërmjet fjalive ose grupeve të fjalive. Me anë të përdorimit të konektorëve, në tekst të dhënë vendoset një lidhje semantiko-logjike midis fjalive apo thënieve të përdorura. Gjithashtu duhet të themi që konektorët nuk janë lidhëza. Lidhëzat janë trajtuar nga gramatika tradicionale në planin përtej fjalisë, ndërsa konektorët shihen, në këndvështrimin e gjuhësisë së tekstit, si mjete lidhëse në planin e ligjërimit.

Në gjuhën shqipe, për konektorët ka disa studime të mirëfillta, në të cilat edhe jemi mbështetur në punimin tonë. Punimi ynë ka si synim të studiojë përdorimin e konektorëve në diskurset politike, sesi përftohen këta konektorë dhe ç'rol luajnë në diskurs.

Ky punim është pjesë e temës së doktoraturës dhe, si tekste argumentuese, kemi zgjedhur të trajtojmë diskursin politik. Diskursi i zgjedhur është fjalimi i Fan Nolit mbajtur në Lidhjen e Kombeve, në Asamblenë e Pestë të Lidhjes, më datë 10 shtator 1924.

Në këtë punim do të paraqesim të gjithë konektorët e përdorur dhe rolin që luan secili prej tyre në këtë diskurs.

Fjalë kyçe: *konektor, diskurs, tekst argumentues*

Konektorët

Tashmë e dimë që për konektorët nuk kemi vetëm një përcaktim nga gjuhëtarët, qofshin këta të fundit shqiptarë apo të huaj. Por, ajo për çka bien dakord është se sipas tyre konektorët janë fjalë apo grupe fjalësh të natyrave të ndryshme që sigurojnë kohezionin e tekstit.

Natyra dhe funksioni i konektorëve logjikë, në gramatikë janë quajtur morfema (si ndajfoljet, lidhëzat nënrenditëse dhe bashkërenditëse, ndonjëherë edhe pasthirrat, që sigurojnë një lidhje midis dy thënieve).

Studimi i konektorëve në perspektivën e gramatikës së tekstit dhe asaj të pragmatikës

Në gramatikën e tekstit konektorët ndihmojnë në kohezionin e tekstit, ndërsa në pragmatikë i shohim në orientimet argumentuese të thënies dhe në marrëdhëniet bisedore.

Për studimin e konektorëve kemi disa gjuhëtarë që kanë dhënë kontributet e tyre.

Moeschler dhe Rebool kanë shkruar për konektorët në fjalorin enciklopedik të pragmatikës (1994, faqe 179). Për konektorët semantikë dhe pragmatikë ka shkruar Van Dijk (1977) sipas të cilit këta konektorë shprehin marrëdhënie mes akteve të të folurit, ndërsa konektorët semantikë shprehin marrëdhënie mes fakteve të denotuara (Linda Mëniku 2013; 62).

Për konektorët argumentues ka shkruar Ducrot dhe AL (1980), për konektorët diskursivë ka shkruar Blake More (1987), për konektorët pragmatikë përmendim Moeschler 1989. Gjithashtu kontribut të veçantë në gjuhën shqipe për konektorët kanë dhënë Linda Meniku dhe Bledar Toska në tezat e tyre të Doktoraturës.

Ducrot (1980) i përcakton konektorët si fjalë ku roli i tyre është të vendosin një lidhje midis dy entiteteve semantike. Sipas tij konektorët luajnë edhe rolin lidhës të përfundimeve, qofshin ato të nënkuptuara apo të drejtpërdrejta.

Ndërkohë sipas Moeschler (1998 : 77) një konektor pragmatik është një shenjë gjuhësore, që i përket kategorive gramatikore që variojnë si lidhëza nënrenditëse dhe lidhëza bashkërenditëse, ndajfolje, lokucione ndajfoljore që sipas tij:

Artikulojnë njësitë gjuhësore maksimale dhe njësitë diskursive.

Japin udhëzime mbi mënyrën sesi lidhen këto njësi.

Imponojnë vazhdimin e frazës.

Në gjuhësinë e tekstit konektorët logjikë janë elemente që sigurojnë vazhdimësinë tekstore, elemente lidhëzore që shënjojnë lidhje semantiko – logjike midis një fraze ose dy frazave.

Nëse i referohemi Gramatikës së Gjuhës Shqipe 2 (2002 ; 426) mjetet e lidhjes leksiko – gramatikore ndahen sipas dy kategorive, në lidhëza semantike dhe lidhëza sintaksore. Sipas gramatikës lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse janë elemente të domosdoshme të strukturës dhe të semantikës së tipave të periudhës lidhëzore. Sipas ndarjes që iu është bërë, lidhëzat semantike kanë një kuptim herë më të përgjithshëm, herë më të ngushtë. Ndërsa lidhëzat sintaksore janë shenja

Përdorimi i konektorëve logjikë në tekstin argumentues

formale gramatikore të varësisë së një fjalie nga një tjetër, ato janë semantikisht boshe.

Konektorët logjikë e vendosin theksin mbi arsyetimin dhe vazhdimësinë e një paragrafi apo një teksti. Konektorët logjikë janë të domosdoshëm në një tekst argumentues për të shprehur lidhjet e ndryshme logjiko - semantike si p.sh. kundërshtimin apo rënien dakord, shkakun dhe pasojën, shpjegimin dhe justifikimin. Përdorimi i konektorëve lejon thënësia/folësia të ndjekë një rrjedhë logjike të atyre që thotë. Por, përdorimi i tyre lejon edhe lexuesin/dëgjuesin të ndjekë gjithë rrjedhën kronologjike të diskursit.

Ndërsa konektorët argumentues shprehin lidhje logjike, të cilët lidhin dy ose më shumë thënie në një diskurs argumentues.

Konektorët logjikë janë ndërtime konceptuale që vlejnjë për të saktësuar dhe përshkruar se çfarë është një arsyetim i vlefshëm. Sipas François Lepage (2001) këto ndërtime janë të domosdoshme për të kuptuar sesi i shprehim arsyetimet logjike në një diskurs.

Le të shohim përdorimin e konektorëve në diskursin që kemi zgjedhur për të analizuar. Kemi të bëjmë me një fjalim të mbajtur nga Fan Nali, i cili i përket diskursit politik.

Në një tekst argumentues konektorët sigurojnë kohezionin tekstor, duke specifikuar marrëdhëniet në etapa të ndryshme të arsyetimit.

Konektorët krijojnë marrëdhënie të ndryshme logjike.

Kemi konektorë që shprehin një fenomen, të cilët janë konektorët shkakorë dhe ata që shprehin pasojë. Kemi konektorë që e pasurojnë dhe e zgjerojnë një argument, të cilët rendisin idetë dhe opinionet dhe që ilustrojnë një argument.

Përdorimi i konektorit kundërshtues *POR* në gjithë diskursin e mbajtur është konektori më i përdorur.

Por, ju lutem, zoti Sekretar i Përgjithshëm, përse refuzoni t'i jepni Shqipërisë një hua që do t'i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më tepër se 300 milion fr. ar. Apo më shumë?

Por do të keni një ide më të qartë kur t'ju them ç'mendoj për të.

Por, pasi ngulni këmbë, ne nuk refuzojmë të bëjmë zgjedhje të reja e të thërresim atë plagë, atë fatkeqësi të madhe, atë bestytini të shëmtuar, që është parlamenti, pasi të kemi bërë dy ose tre vjet qeverimi atëror.

Por ç'fjalime, ç'fjalime të bukura, të fryra e të stërfryra do të shoqërojnë këto rezoluta e këto dëshira!

Por ja, përse jua drejtova fjalën sot.

Por a është vërtet një flluskë?

Por jo, nuk është aspak një flluskë; ajo që doja të thosha është se kjo hua mund të përgatitë paqen në Ballkan, ajo mund të lehtësojë realizimin e konfederatës ballkanike; por ia vlen të flitet për të?

Por paqja nuk do të vijë prej traktateve; këto janë të destinuara të hidhen shpejt a vonë në shportë.

Konektori *por* i lejon ligjëruesit të vendosë në kundërshtim me njëri – tjetrin gjithmonë dy fakte ose dy argumente për të nxjerrë në pah vlerat e njërit prej këtyre të dyve.

Por paqja nuk do të vijë prej traktateve; këto janë të destinuara të hidhen shpejt a vonë në shportë. Paqja do të vijë nga edukimi shkollor

Konektori *por* mohon dhe hedh poshtë atë që të tjerët kanë thanë se Paqja do të vijë prej traktateve, dhe pasi ligjëruesi ka kundërshtuar hapur, ka dhënë argumentin e tij se nga do të vijë paqja.

Ky konektor, jo gjithmonë shpreh marrëdhënie kundërshtore, ai mund të përdoret edhe për të ndryshuar rrjedhën e idesë, apo temës për të cilën flitet. Në shembullin e mëposhtëm ligjëruesi ka kapërcyer rrjedhën e argumenteve dhe ka filluar të flasë për një temë tjetër.

Siç e dini, Shqipëria ishte një kaçkë e fortë për t'u thyer dhe më e rëndë për t'u ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mençuri vendosi ta lërë Shqipërinë të qetë, të lirë, të lagur nga valët e Adriatikut.

Por, ju lutem, zoti Sekretar i Përgjithshëm, përse refuzoni t'i jepni Shqipërisë një hua që do t'i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më tepër se 300 milion fr. ar. Apo më shumë?

Siç e shohim konektori ndihmon rrjedhën e frazës së parë, por duke kaluar në një temë tjetër.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një konektor kundërshtor, dhe sipas Linda Meniku (2013) ata përdoren për të shprehur lloje të ndryshme marrëdhëniesh kundërshtore.

Këtë konektor e gjejmë të përdorur si në krye të fjalisë ashtu edhe në mes të saj.

Le të shohim konektorët logjikë të përdorur në diskurs dhe funksionin që ata luajnë sipas rastit, duke e rimarrë shembullin e mësipërm.

Siç e dini, Shqipëria ishte një kaçkë e fortë për t'u thyer dhe më e rëndë për t'u ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mençuri vendosi ta lërë Shqipërinë të qetë, të lirë, të lagur nga valët e Adriatikut.

Në këtë rast kemi të bëjmë me dy konektorë logjikë brenda së njëjtës frazë. I pari është një konektor që shërben për të ilustruar, duke lejuar ligjëruesin të zbardhë argumentin e tij rreth një rasti konkret.

Edhe pse kemi të bëjmë me një konektor që lejon të ilustrojë, gjithashtu na jepet edhe një shkak, i cili do të pasojë me një pasojë me përdorimin e konektorit *kështu që*, i cili kalon në një marrëdhënie rrjedhimore.

Sipas Linda Meniku (2013) konektori *kështu që* shpreh një marrëdhënie të ngjashme shkak – pasojë, por që markon argumentin tjetër.

Në shembullin e mësipërm konektori *kështu që* mund të zëvendësohet edhe me konektorin *për këtë arsye* pa ndryshuar pozicionin që ka. Në shembujt e tjerë mund ta gjejmë edhe në krye të frazës, jo vetëm në mes.

Konektori tjetër që ka një përdorim të shpeshtë në fjalimin e zgjedhur është edhe konektori *dhe*, i cili është përdorur në krye të frazës edhe në mes të saj.

Dhe kjo do të thotë, natyrisht, se e gjithë kjo histori ka mbaruar siç mbarojnë flluskat e sapunit.

Aspiratat për paqe i kemi kudo dhe për këtë s'ka asnjë dyshim.

Ky konektor ka një marrëdhënie logjike shtesore dhe klasifikuese, i cili lejon ligjëruesin të shtojë një argument ose një shembull të ri në morinë e shembujve të mëparshëm.

Atëherë po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh.

Atëherë merreni këtë kërkesën time dhe varroseni në dosjet e vdekura të Sekretariatit, kyçeni mirë dhe mbyteni fort përpara se ta futni nën akropolin tuaj, sepse mund t'ju dalë nga varri.

Ky konektor shpreh një pasojë që lejon të tregojë rezultatin e një fakti apo ideje.

Mirë, pra, le të flasim për paqen. Më duket nuk ka gjë tjetër më të keqe se sa të bëjmë këtë. Them “më duket” – I guess – sepse dua që ju të gjithë të dini se unë kam banuar për shumë vjet në Amerikë, në Boston.

Në këtë shembull kemi të bëjmë me një konektor shkakor, i cili e lejon ligjëruesin të tregojë arsyen e një fakti apo ideje.

Konektorët logjikë janë të domosdoshëm në prodhimin e një teksti koherent sepse ata kanë një funksion procedural.

Së pari, përdorimi i konektorëve i vendosë ngjarjet, personazhet dhe objektet në kohë dhe hapësirë. Ata kanë një rol përcaktues në koherencën dhe progresionin e tekstit.

Së dyti, ata strukturojnë informacionet duke shënjuar zinxhirin e frazave, tranzicionet e pjesëve të tekstit dhe merren me funksionin organizues të tij.

Së treti, ata i sigurojnë lexuesit apo dëgjuesit një kuptim sa më të mirë pavarësisht gjatësisë apo nivelit të vështirësisë që mund të ketë.

Dhe së fundmi ata e thjeshtojnë ndërtimin e një përfaqësimi mendor konform situatës së përshkruar në tekst, dhe e drejtojnë lexuesin drejt zgjedhjes që ai duhet të bëjë për të kuptuar qëllimet e ligjëruesit/autorit.

BIBLOGRAFI

- Blakemore, D., *Semantic Constraints on Relevance*. Blackwell, Oxford, 1987.
- Ducrot, O. et al., *Les mots du discours*. Éd. de Minuit, Paris, 1980.
<http://www.albeu.com/dossier/fjalimi-i-rralle-i-fan-nolit-ne-asamblene-e-lidhjes-se-kombeve/166302/>
- Lepage, F., *Éléments de logique contemporaine*, PUM, 2001.
- Meniku, L., *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*, Doktoratura, Tiranë 2013.
- Moescheler, J.: *Argumentation et conversation: éléments pour une analyse pragmatique du discours*, Paris Hatier/Crédif. (1985).
- Moeschler, J.,. *Connecteurs pragmatiques, inférences directionnelles et représentations mentales*. In: Molendijk, A., Vet, C. (Eds.), *Temporalité et attitude. Structuration du discours et expression de la modalité*. Cahiers Chronos 12, 35-50. 2005.
- Moescheler, J *Dictionnaire encyclopédique de pragmatique*, Seuil, 1994, Coécrit avec Anne Reboul.
- Reboul, A., Moeschler J., 1998. *La Pragmatique aujourd'hui. Une nouvelle science de la communication*. Éd. du Seuil, Paris.
- Teun A. van Dijk, *Text and context: Explorations in the semantics and pragmatics of discourse*, Londres, Longman, 1977.
- Toska, B., *Studim për qasës i konektorëve në tekstet argumentues të gjuhës angleze dhe asaj shqipe*, Doktoraturë, Tiranë 2012.